



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.52

16 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ nr.2, datë 8.4.2008	Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Evropian	2327
Udhëzim i MASH nr.14, datë 3.4.2008	Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë.....	2329
Udhëzim i MASH nr.15, datë 4.4.2008	Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë.....	2336
Udhëzim i MF nr.14, datë 2.4.2008	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar	2351
Vendim i GJK nr.11, datë 2.4.2008	Me objekt shfuqizimin e nenit 315 të Kodit Penal si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 315 të Kodit Penal.....	2352
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Enkeleid Gjuzi.....	2362

AKT NORMATIV
Nr.2, datë 8.4.2008

**PËR DËRGIMIN NË BOSNJË-HERCEGOVINË TË NJË GRUPI TË ASGJËSIMIT TË
MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN “ALTHEA”
TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve (AME), të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Europian, në zbatim të rezolutës nr.1551, datë 9.7.2004 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në operacionin “ALTHEA”, për ditët e qëndrimit në këtë operacion, veç pagës mujore marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ligji nr.9315, datë 11.11.2004 “Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare në Bosnjë-Hercegovinë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Europian”, shfuqizohet.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOSTJA INDIVIDUALE

Nr.	Kostoja individuale	Nr.i personave	Vlera ditore	Ditë	Shuma/euro	Shuma 000/lekë
I	DIETA	13	70	180	163800	20311
	Ushqim, ujë, larje & akomodim	13	18.6	180	43524	5397
	Shuma				207324	25708
II	Sigurim shëndetësor	13	12	180	28080	3482
	Sigurim jete	13	365	180	8541	854
	Shuma				36621	4336
III	Viza për Boznjë-Hercegovinë	13	50		650	81
	Shuma				0	81
TOTALI					243945	30125

KOSTOJA E SHPENZIMEVE TË TJERA

Nr.	Kostoja e shpenzimeve të tjera			Norma e karburantit për 100/km	Sasia e ditëve	Çmimi për litër (euro)	Vlera për 6 muaj (euro)	Vlera për 6 muaj (1000/lekë)
1	Shpenzime për karburant për 4 mjete	4 mjete	460 km/mjet/muaj	25 litra	6 muaj	0.81	8942	1109
2	Shpenzime për vajtje-ardhje Tiranë-Bosnjë e kthim	3 mjete	4800 km	25 litra	2 ditë	0.81	11664	1446
3	Qira magazinimi	2 depo	13 euro/ditë		180 ditë		2400	298
4	Shërbime telefonike (fiks, celular)	1 tel.fiks dhe 2 cel.			180 ditë		10290	1276
5	Mirëmbajtje e mjeteve të transportit e pajisje				180 ditë		4000	496
TOTALI							37296	4625

PASQYRË PËRMBLEDHËSE

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Numri i pjesëmarrësve	Sasia e ditëve	Vlefata në euro	Vlefata në 000/lekë
1	Kostoja individuale për 6 muaj	13	180	243945	30125
2	Kostoja e shpenzimeve të tjera	13	180	37296	4625
SHUMA TOTALE				281241	34750

UDHËZIM
Nr.14, datë 3.4.2008

PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, pika 1.2.1, nenit 98, paragrafi i dytë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Programet e studimit të ciklit të dytë, përcaktuar në pikën 1.2.1 të nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përbëjnë nivelin e dytë të formimit universitar, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND) në fushën e arsimit të kryer.

2. Programet e mësipërme të studimit të ciklit të dytë organizohen dhe ofrohen vetëm nga institucionet e përcaktuara në nenet 5, pika 4 dhe 6, pikat 1, 2 e 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

4. Programet e studimit të ciklit të dytë, nëpërmjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, duhet të garantojnë:

a) specializim të njohurive të studentëve, krahasuar me programet e studimit të ciklit të parë;
b) përgatitje të avancuar të tyre për formimin e kompetencave dhe aftësive, që iu korrespondojnë niveleve të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizimit;

c) trajnim për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të kërkimit.

5. Programet e studimit të ciklit të dytë mund të jenë edhe ndërdisiplinore ose/dhe të përbashkëta.

6. Programet e studimit të ciklit të dytë duhet të hartohen në mënyrë të tillë që:

a) të shmangin përsëritjen e njohurive formuese të programeve të studimit të ciklit të parë, duke ofruar disiplina të një karakteri më të avancuar e specializues;

b) kurrikulat e tyre t'i korrespondojnë një formimi bazë të gjerë dhe fleksibël, duke ju dhënë peshë programeve ndërdisiplinore, me qëllim mundësimin e pranimin në këto programe studimi si të studentëve të diplomuar në programin respektiv të studimit të ciklit të parë, ashtu dhe të atyre të diplomuar në programe të afërta studimi të ciklit të parë;

c) të reflektojnë bashkëpunimin me tregun e punës dhe profesioneve në nivel kombëtar dhe lokal.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, përcaktojnë listën e programeve të studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në një program studimi të ciklit të dytë, si më poshtë:

a) programin apo programet e studimit të ciklit të parë, që lejojnë regjistrimin në programin e studimit të ciklit të dytë pa plotësime shtesë (pa debite formimi);

b) programin apo programet e studimit të ciklit të parë, që lejojnë regjistrimin në programin e studimit të ciklit të dytë me plotësim të njohurive formuese (me debite formimi), si p.sh. programe studimi të afërta të të njëjtit institucion apo programe të njëjta e të afërta të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Në çdo program studimi të ciklit të dytë, së paku një program studimi i ciklit të parë kalon pa debite formimi.

8. Në programet e studimit të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 7 përfshihen programet, njohuritë formuese të të cilave konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre, (jo më pak se 120 kredite).

Vlerësimi i programeve të studimit të ciklit të parë kryhet nga një grup profesorësh të njësisë kryesore, ku do të zhvillohet programi i studimit të ciklit të dytë (strukturë përgjegjëse), të caktuar nga dekani.

a) Kur një programi studimi të ciklit të parë i vlerësohen të pranueshme jo më pak se 120 kredite, struktura akademike përgjegjëse përcakton disiplinat në të cilat studenti duhet të bëjë plotësimet e krediteve të mangëta (debiteve të formimit). Në çdo rast, numri maksimal i krediteve të mangëta për t'u plotësuar nuk duhet të kalojë 60 kreditet.

9. Mund të njihen si kredite të realizuara, për një program studimi të ciklit të dytë, kredite të fituara në programet master i nivelit të parë, po jo më shumë se 12-15 kredite.

Nuk njihen si kredite të realizuara, për një program studimi të ciklit të dytë, kredite të fituara në çfarëdo program studimi të ciklit të parë.

10. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të dytë, japin informacionet e nevojshme për plotësimin e njohurive formuese (debiteve të formimit) sipas përcaktimit në pikën 8 "a" më sipër. Ato përcaktojnë edhe procedurat për kryerjen e këtyre plotësimeve para pranimit në programin e studimit të ciklit të dytë, duke organizuar për këtë qëllim dhe shërbime të nevojshme të tutoratit (kujdestarisë) për studentët.

11. Për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, njësitë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) personel akademik me kualifikimin, kompetencat kurrikulare dhe në numrin e nevojshëm, për zhvillimin e disiplinave të ndryshme të programit të studimit;

b) infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme mësimore, laboratorike, kompjuterike, publikime etj., për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit;

c) mundësi për realizimin e tezës së diplomës.

Institucionet publike të arsimit të lartë mund të përcaktojnë, përveç titullit apo titujve të diplomave të nivelit të parë që duhet të zotërohen së paku nga studentët si kusht për pranimin e tyre në një program studimi të caktuar të ciklit të dytë, edhe kritere të tjera specifike, sipas përcaktimit në nenin 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.

12. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të dytë, parashikohet realizimi i një teze diplome, si pjesë përbërëse e tij.

13. Programet e studimit të ciklit të dytë funksionojnë në përputhje me rregulloret përkatëse të tyre.

14. Institucionet publike të arsimit të lartë, kërkesën e tyre për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, e shoqërojnë me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) objektivat formues të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi;

b) planin mësimor të programit, të detajuar në aktivitetet e ndryshme formuese, shoqëruar me kreditet dhe orët mësimore përkatëse;

c) personelin akademik, që do të angazhohet për realizimin e programit të studimit, shoqëruar edhe me të dhënat e nevojshme të kualifikimit të tij dhe të fushave mësimore e kërkimore të mbuluara prej tij;

d) kriteret e pranimit të studentëve;

e) programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në programin e studimit, pa ose me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

f) mundësitë e transferimit të studentëve ndërmjet programeve të studimit të ciklit të dytë;

g) modalitetet e përgatitjes, paraqitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës;

h) numrin minimal dhe maksimal të pjesëmarrësve në program;

i) frekuencën në aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, praktika etj.);

j) strukturën akademike përgjegjëse;

k) propozimin për tarifën e shkollimit, të argumentuar lidhur me koston;

l) rregulloren e programit të studimit;

m) Modelin e diplomës dhe suplementit të diplomës.

Formati për paraqitjen e dokumentacionit për elementet kryesore të cituara më sipër, të përgatitet sipas modelit në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Dokumentacioni tjetër i kërkuar në këtë pikë të bashkëlidhet si pjesë përbërëse e propozimit.

15. Propozimet për hapjen/organizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë bëhen nga një apo më shumë njësi kryesore apo njësi bazë.

Këto propozime shqyrtohen dhe miratohen në këshillin e njësisë kryesore përkatëse dhe në senatin akademik të institucionit.

16. Kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë duhet të paraqiten në MASH brenda datës 31 mars të çdo viti.

Për vitin akademik në vazhdim kërkesat mund të bëhen deri në 30 maj 2008.

17. Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, si dhe mbështetur në këtë udhëzim.

18. Licencimi dhe hapja e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet private të arsimit të lartë bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007. Institucionet private të arsimit të lartë, që do të ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë, u nënshtrohen rregullave të përcaktuara në udhëzimet specifike, për hapjen e tyre, dhe këtij udhëzimi për organizimin e studimeve në to.

Institucionet private të arsimit të lartë i nënshtrohen rregullit të pikës 11 të këtij udhëzimi vetëm për organizimin e studimeve.

Këto institucione përjashtohen nga rregullat e përcaktuara në pikat 15, 16 dhe 17 të këtij udhëzimi duke iu nënshtuar për hapjen e programeve të studimit rregullave të përcaktuara në aktet specifike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

Shtojca 1

Institucioni i arsimit të lartë

PROPOZIM PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E PRORAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

Viti akademik:

1. Emërtimi i përgjithshëm i programit të studimit

2. Vendimet e organeve përgjegjëse për hapjen e programit të studimit

Vendimi i këshillit të njësisë kryesore për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë (Numri i vendimit dhe data)	
Vendimi i senatit akademik për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë (Numri i vendimit dhe data)	

Në rastin kur programi i studimit është ndërdisiplinor apo/dhe i përbashkët, të përfshihen të gjitha vendimet e marra, sipas modelit më sipër.

3. Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit

b) Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

c) Mundësitë për punësim

4. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë.	
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjekte të tjera publike apo private	

Në rastin e bashkëpunimit me një apo disa struktura të tjera të bashkëlidhen marrëveshjet përkatëse.

5. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit hartohet duke marrë në konsideratë dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”

Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues për të	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i krediteve
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (Simboli: A)	1.		
	2.		
	3. ...		
		
Veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit (Simboli: B)	1.		
	2.		
	3. ...		
		
Veprimtari në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese, që lidhen me disiplinat	1.		
	2.		

karakterizuese (Simboli: C)	3.		
Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni (Simboli: D)	1.		
	2.		
	3.		
Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika etj. (Simboli: E)	1.		
	2.		
	3.		
Teza e diplomës (Simboli: F)			
Totali			120

Germat A- F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese.

Në programin e studimit parashikohen:

- | | | | | |
|------------------------|--------------------------|----|--------------------------|----|
| - leksione | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - ushtrime | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - laboratore | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - projekt/detyra | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - seminare | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - praktikë, stazh etj. | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |

6. Personeli akademik për realizimin e programit

Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti/qendra njësia kryesore	Sektori mësimor- kërkimor

7. Plani mësimor

Disiplina mësimore apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprimtarisë (A - F)	Frekuentimi	Kreditet	Orët mësimore në auditor
VITI I - SEMESTRI I				
1.				
2.				
Totali		 kredite orë
VITI I - SEMESTRI II				
1.				
2.				

Totali		 kredite orë
VITI II - SEMESTRI I				
1.				
2.				
Totali		 kredite orë
VITI II - SEMESTRI II				
1.				
2.				
Totali		 kredite orë
Totali i përgjithshëm		 kredite orë

8. Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në programin e studimit të ciklit të dytë

a) pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilat nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1.
	2. <input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1.
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>

b) me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	1.	<input type="checkbox"/>kredite
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>kredite
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	1.kredite
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>kredite

9. Infrastruktura në dispozicion të programit

Informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike etj.

10. Kriteria specifike të pranimit të studentëve në program

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	

Kriteria të tjera pranimi (nëse ka)

1	
2	
3	

11. Tarifa e shkollimit

Tarifa e shkollimit		Kostoja e shkollimit	
---------------------	--	----------------------	--

12. Financime të tjera

Financime të tjera që mund të mbulojnë pjesërisht apo plotësisht koston e shkollimit, në se ka të tilla.

REKTORI
Firma, vula

Data _____

UDHËZIM Nr.15, datë 4.4.2008

PËR ORGANIZIMIN E STUDIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 dhe nenit 98, paragrafi i dytë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Programet e studimit dhe titujt përkatës të diplomave

1. Programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë, programet e integruara të studimit të ciklit të dytë dhe programet e studimit të doktoratës organizohen në cikle të njëpasnjëshme studimi, dhe respektivisht sipas cikleve, lëshohen diplomat:

- “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në fushën e arsimimit të kryer;
- “Diplomë e nivelit të dytë” (DND) në fushën e arsimimit të kryer;
- “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND) në fushën e arsimimit të kryer;

d) “Diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr)”.

2. Diploma e nivelit të parë DNP, diploma e nivelit të dytë DND, diploma e integruar e nivelit të dytë DIND, dhe diploma për gradën shkencore “Doktor”, lëshohen pas përfundimit respektivisht të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë apo të ciklit të parë dhe të dytë së bashku, e të ciklit të tretë (doktorata), të kryera në institucione të arsimit të lartë.

3. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, përcaktuar në nenin 26, pika 1.2.2.a., të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, janë programe të studimit të ciklit të parë dhe të dytë së bashku, për të cilat nuk parashikohen tituj universitarë të ciklit të parë.

Programet e studimeve, të cilat organizohen si programe të integruara studimi të ciklit të dytë, jepen në listën bashkëlidhur këtij udhëzimi. Listës mund t'i shtohen, me propozim të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, edhe programe të tjera studimesh të integruara të ciklit të dytë.

4. Programet e studimit të doktoratës, përcaktuar në nenin 26, pika 1.3.1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur, duke përfshirë edhe 60 kredite për studime të organizuara.

Për fitimin e diplomës për gradën shkencore “Doktor” (Dr), studentët duhet të përmbushin edhe detyrimet e tjera që përcaktohen nga vendimi nr.864, datë 5.12.2007 i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore doktor”.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë lëshojnë, gjithashtu, diplomat:

a) Diplomën “Master i nivelit të parë” (MNP) në fushën e arsimimit dhe trajnimit të kryer, në përfundim të programeve të studimit master i nivelit të parë, pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe që realizojnë arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional të studentit, sipas nenit 26, pika 1.2.3, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

b) Diplomën “Master i nivelit të dytë” (MND), në përfundim të programeve të studimit master i nivelit të dytë, pjesë e studimeve të ciklit të tretë dhe që realizojnë arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë profesional ose shkencor të studentit, sipas nenit 26, pika 1.3.4., të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

c) Diplomën me titull “Specialist ...”, për shkencat mjekësore ose “Magjistër...”, për shkencat politike, juridike dhe sociale, ndjekur nga fusha e specializimit të kryer, në përfundim të një programi specializues afatgjatë, pjesë e studimeve të ciklit të tretë. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë profesionalisht të orientuara dhe ofrojnë njohuri për profesione specifike në fushat e mjekësisë, stomatologjisë, veterinarisë, drejtësisë etj., sipas nenit 26, pika 1.3.2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në nenin 30 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, mund të ofrojnë edhe programe të formimit të vazhduar për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive, programe të kërkimit të avancuar, kurse e shkolla verore etj., në varësi të programeve të studimit që institucioni ofron, në përfundim të të cilave lëshohet certifikatë.

Struktura dhe kohëzgjatja e këtyre programeve përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Hapja e tyre bëhet pasi Ministria e Arsimit dhe e Shkencës shprehet formalisht për njohjen e propozimit të ardhur nga institucioni publik i arsimit të lartë. Propozimi përmban emërtimin e programit, strukturën dhe kohëzgjatjen e tij, si dhe modelin e certifikatës që do të lëshohet në përfundim të programit.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të ofrojnë, mbështetur në nenin 26, pika 4 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, programe të studimeve jouniversitare dyvjeçare, të natyrës profesionale, në përfundim të të cilave lëshohen diplomat përkatëse.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë apo njësi kryesore të tyre, në bazë të marrëveshjes, mund t'i ofrojnë programet e mësipërme të studimeve edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. Në marrëveshje përcaktohet dhe tipi i diplomës që lëshohet, që mund të jetë diplomë e përbashkët e të dy institucioneve ose diplomë e dyfishtë, lëshuar nga secili institucion. Në të dyja rastet, në diplomat përkatëse shënohen institucionet bashkëpunuese.

II. Kreditet

1. Një krediti të formimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit.
2. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh universitare nga një student me kohë të plotë është 60 kredite apo 1500 orë mësimore punë të studentit, që përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij.
3. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore.
4. Ngarkesa javore në auditor për leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorë është në intervalin e 20 - 25 orëve mësimore 60-minutëshe.
5. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (provimin).
6. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin institucion, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një institucion tjetër të arsimit të lartë, bëhet nga njësia që pret studentin, me procedura dhe kritere të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.
7. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kritereve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuar sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.

Numri maksimal i krediteve të njohura në këtë rast nuk kalon 60 kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.

8. Në rregulloret mësimore të institucioneve parashikohen kontrole për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara nga studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet, kontrole këto për të garantuar mosvjetrimin e dijeve dhe azhurnimin e tyre për kreditet e fituara nga studentët. Edhe studentëve që i kanë zgjatur studimet për më shumë se tre vjet, përtej kohës normale të fitimit të diplomës për një program të caktuar studimi, para dhënies së tezës së diplomës iu kontrollohen gjithashtu kreditet e fituara.

III. Kushtet e pranimit në programet e ndryshme të studimit

1. Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të parë apo program të integruar të studimit të ciklit të dytë, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore, të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të ose të zotërojë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë.

Institucionet publike të arsimit të lartë mund të përcaktojnë në përputhje me aktet ligjore në fuqi edhe kritere të veçanta pranimi për kandidatët, të cilët kanë mbaruar maturën shtetërore, të cilat i bëjnë publike të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

2. Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të dytë, kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të parë ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret mësimore përkatëse kritere specifike për pranimin e studentëve në çdo program studimi të ciklit të dytë, që lidhen me drejtimin e formimit të tyre në ciklin e parë dhe kualitetin e përgatitjes individuale të studentëve, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Këto kritere specifike bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

3. Për t'u pranuar në një program studimi të doktoratës kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, ekuivalente me to. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kritere specifike të pranimit në programet e doktoratës, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Këto kritere bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

4. Për t'u pranuar në një program studimi specializimi afatgjatë, kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, ekuivalente me to, dhe të plotësojë standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriterë specifike të pranimit në këto programe studimi, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

5. Për t'u pranuar në një program studimi "Master i Nivelit të Parë" (MNP) kandidati duhet të ketë përfunduar së paku një program studimi të ciklit të parë, si dhe të plotësojë standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

6. Për t'u pranuar në një program studimi "Master i Nivelit të Dytë" (MND) kandidati duhet të ketë përfunduar së paku një program studimi të ciklit të dytë apo program të integruar të studimi të ciklit të dytë, si dhe të plotësojë standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

7. Për t'u pranuar në një program studimi jouniversitar, të natyrës profesionale, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore ose të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, si dhe të plotësojë standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

8. Ekuivalentimi i titujve të studimit të fituar jashtë vendit, me qëllim pranimin në programet e ndryshme të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

IV. Fitimi i diplomave të studimit

1. Për të fituar një diplomë të nivelit të parë (DNP), studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite.

2. Për të fituar një diplomë të nivelit të dytë (DND), studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.

3. Për të fituar një diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND), studenti duhet të ketë grumbulluar së paku 300 kredite.

4. Për të fituar një diplomë të masterit të nivelit të parë (MNP), studenti duhet të ketë grumbulluar 60 kredite.

5. Për të fituar një diplomë të masterit të nivelit të dytë (MND), studenti duhet të ketë grumbulluar të paktën 60 kredite.

6. Për të fituar një diplomë të një programi studimi jouniversitar, studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.

7. Për të fituar një certifikatë në përfundim të një programi studimi të formimit të vazhduar, studenti duhet të ketë grumbulluar numrin e nevojshëm të krediteve, të përcaktuar nga institucioni respektiv i arsimit të lartë për atë program studimi.

V. Kohëzgjatja e programeve të studimit me kohë të plotë

1. Për çdo program studimi me kohë të plotë është përcaktuar si normë një kohëzgjatje në vite, proporcionale me numrin total të krediteve, përcaktuar në kreun IV të këtij udhëzimi, duke pasur parasysh që një viti i korrespondojnë 60 kredite.

2. Mbështetur në pikën 1 të këtij kreu, kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë është tre vite, kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë është edhe dy vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të parë, kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë është së paku pesë vite.

3. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të doktoratës është së paku tre vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të dytë apo programi të integruar të studimit të ciklit të dytë.

4. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata është së paku dy vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të dytë apo programi të integruar të studimit të ciklit të dytë.

5. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit jouniversitar me kohë të plotë është dy vite.

6. Kohëzgjatja e programeve të ndryshme të studimit të formimit të vazhduar përcaktohet në mënyrë të pavarur nga secili institucion i arsimit të lartë.

7. Kur një program studimi ofrohet me kohë të pjesshme ose në distancë, kohëzgjatja e programit të studimit do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për organizimin e formave të studimit me kohë të pjesshme dhe në distancë.

8. Kohëzgjatja për programet e studimit të doktoratës do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin nr.5, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

VI. Hapja e programeve të studimit

1. Hapja e programeve të ndryshme të studimit, sipas pikës 1 të kreut I të këtij udhëzimi, bëhet kur plotësohen kriteret strukturore, organizative, si dhe kriteret lidhur me personelin akademik, që do të aktivizohet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, duke pasur parasysh dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.

Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë bëhen pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 dhe udhëzimit përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të doktoratës bëhen pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, në vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore “Doktor”, udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse”, si dhe akteve të tjera nënligjore lidhur me organizimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve.

Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” dhe “Master i nivelit të dytë”, bëhen mbështetur në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 dhe udhëzimin nr.4, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit master i nivelit të parë dhe master i nivelit të dytë”.

2. Hapja e këtyre programeve të studimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, para se të marrë vendim, kërkon vlerësimin e programeve të studimit prej Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Vetëm në rastin e një vlerësimi pozitiv, ajo përcjell propozimin e saj në Këshillin e Ministrave.

3. Në rastin e mbylljes së një programi studimi, institucionet publike të arsimit të lartë duhet të parashikojnë për studentët mundësinë e përfundimit të studimeve në një program të njëjtë ose të ngjashëm studimi.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë publikojnë në faqen zyrtare të institucionit, programet e studimit të ofruara prej tyre.

VII. Objektivat dhe veprimtaritë formuese të një programi studimi

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi ndahen: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj.) dhe veprimtari të tjera, si praktika profesionale apo stazh pranë subjekteve publike apo private.

Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohet nga personeli akademik përgjegjës për disiplinën, në bazë të krediteve që asaj discipline i janë caktuar.

2. Çdo program studimi ka objektiva të caktuar për formimin e studentëve në atë program, të cilat përbëhen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin kulturor e profesional të programit.

3. Objektivat për formimin e studentëve në një program studimi ndahen në:

a) Objektiva përcaktues të programit të studimit, të cilat janë të njëjta për programe studimi të njëjta apo të ngjashme, të ofruara nga institucione të ndryshme publike të arsimit të lartë. Këto përcaktojnë përgatitjen, njohuritë, kompetencat dhe mundësitë për punësim dhe janë të njëjta, pavarësisht institucionit publik të arsimit të lartë që i ofron apo emërtimit të programit.

b) Objektiva specifike, të cilët diferencojnë programet e njëjta ose të ngjashme nga njëri-tjetri. Këto përcaktohen veças nga secili institucion publik i arsimit të lartë që ofron atë program studimi.

4. Për çdo program të caktuar studimi, objektivat formues përcaktues të programit dhe veprimtaritë formuese të domosdoshme për t'u ndjekur grupohen si më poshtë:

a) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që lidhen me formimin e përgjithshëm (bazë) për programin e studimit;

b) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash, që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit;

5. Përveç veprimtarive formuese të përcaktuara në pikën 4, shkronjat "a" dhe "b", të këtij kreu, programet e studimit duhet të parashikojnë, gjithashtu:

a) veprimtari formuese të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;

b) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese (pika 4.b e këtij kreu), që lidhen kryesisht me formime ndërdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.

c) veprimtari formuese të paparashikuara më sipër dhe të fokusuara drejt përfundimit të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës, sikurse dhe aktivitete formuese që lidhen me praktikat profesionale pranë kompanive të ndryshme, administratës publike, enteve private apo publike, urdhrave apo kolegjeve profesionale, bazuar në marrëveshje të përbashkëta për këtë qëllim.

d) veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës;

6. Në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepen rekomandime për shpërndarjen e krediteve sipas veprimtarive të ndryshme formuese, si dhe ndarjen e orëve mësimore për një kredit në orë në auditor dhe orë për studim individual.

7. Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u njehsohet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepet një shembull i njehsimit të notës mesatare të ponderuar.

VIII. Rregullorja mësimore e institucioneve publike të arsimit të lartë

1. Institucionet publike të arsimit të lartë duhet të kenë rregulloren mësimore të tyre, në të cilën përcaktohet organizimi i planeve mësimore për të gjitha programet e studimit që ofrohen, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, akteve nënligjore në fuqi dhe normave të përcaktuara në statutin e institucionit.

2. Rregullorja mësimore e institucionit, si edhe modifikimet e ndryshme të saj, miratohen në senatin akademik.

3. Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

- a) emërtimi dhe objektivat formues të programit të studimit;
- b) kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese që duhen përfshirë në kurrikula;
- c) kreditet për çdo veprimtari formuese, të përcaktuara sipas pikës 4, shkronjat “a” dhe “b” dhe pikën 5, shkronjat “a”, “b”, “c” e “d”, të kreut VII;

d) karakteristikat e tezës së diplomës.

4. Për fitimin e diplomës së nivelit të parë (DNP) parashikohet përgatitja e një teze diplome, pa kërkesa për origjinalitet të veçantë.

Për fitimin e diplomave të nivelit të dytë (DND) dhe diplomave të integruara të nivelit të dytë (DIND), duhet të parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë të pavarur dhe krijuese nga studenti.

5. Për përcaktimet e pikës 3 të këtij kreu, institucionet publike të arsimit të lartë konsultohen paraprakisht me përfaqësues të bizneseve, shërbimeve apo profesioneve respektive, duke iu referuar gjithashtu edhe nevojave e kërkesave të tregut.

6. Rregullorja mësimore e institucionit përcakton, gjithashtu, aspekte të organizimit dhe administrimit të veprimtarive mësimore të përbashkëta për programet e studimit, si:

a) kriteret specifike të pranimit të studentëve në programet e studimit;

b) objektivat, afatet dhe mënyrat me të cilat strukturat përgjegjëse akademike parashikojnë kolegjisht programimin e veprimtarive të ndryshme formuese, koordinimin dhe verifikimin e rezultateve të tyre;

c) procedurat për ndarjen e detyrimeve mësimore vjetore kategorive të personelit akademik;

d) procedurat për zhvillimin e provimeve apo formave të tjera të kontrollit përfundimtar të dijeve të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese, e kontrolleve të pjesshme të dijeve, si dhe të paraqitjes e diskutimit të tezës së diplomës;

e) modalitetet për dhënien e diplomave, përcaktuar në kreun I të këtij udhëzimi.

f) kriteret dhe procedurat për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga studentët që kërkojnë të transferohen apo t’u njihen dije të fituara më parë të pas shkollës së mesme;

g) organizimin e plotësimit të debiteve formuese para hyrjes në një program studimi të ciklit të dytë;

h) organizimin e shërbimit për koordinimin e aktiviteteve orientuese për nxënësit në bashkëpunim me shkollat e mesme, si dhe shërbimin për çdo program studimi të kujdestarisë (tutoratit) për studentët, referuar përcaktimeve në pikën XI të këtij udhëzimi;

i) vlerësimin e cilësisë së të gjitha veprimtarive të kryera;

j) format e publikimit të procedurave të ndryshme dhe vendimeve të marra;

k) modalitetet e caktimit, për çdo veprimtari, të strukturës apo personit që mban përgjegjësi etj.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë caktojnë për çdo disiplinë/lëndë një numër të përshtatshëm kreditesh, duke evituar ndarjen në pjesë të vogla /copëzimin, e veprimtarive formuese. Për çdo program studimi të ciklit të parë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 22 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese, duke realizuar provime të integruara për më shumë se një disiplinë apo module të koordinuara.

Në këto raste, lektorët (titullarët) e këtyre disiplinave bëjnë vlerësim kolegjal të studentit, sipas modaliteteve të parashikuara në rregulloren mësimore të institucionit.

Për çdo program studimi të ciklit të dytë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 14 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Për programet e integruara të ciklit të dytë, përcaktuar në pikën 1, shkronja “c”, të kreut I të këtij udhëzimi, nuk mund të parashikohen në total më shumë se 35 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

8. Rregullorja mësimore e institucionit përcakton edhe modalitetet dhe formën e dhënies së Suplementit të diplomës, në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë apo programeve të integruara të ciklit të dytë, si dhe të programeve “Master i nivelit të dytë”, bazuar në udhëzimin nr.12 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, datë 14.5.2007 “Për akordimin e “shtojcës së diplomës” (suplementit të diplomës) nga të gjitha shkollat e larta”.

IX. Rregulloret mësimore të programeve të studimit

1. Institucionet publike të arsimit të lartë organizojnë çdo program studimi nëpërmjet rregullores mësimore përkatëse.

2. Rregullorja mësimore e një programi studimi, e hartuar nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me planin mësimor dhe duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve, specifikon aspektet organizative të programit të studimit. Rregullorja miratohet sipas procedurave të përcaktuara në statutin e institucionit.

3. Rregullorja mësimore e një programi studimi përcakton në veçanti:

- a) listën e disiplinave mësimore, të ndara në module, si dhe veprimtaritë e tjera formuese;
- b) objektivat formues specifikë të çdo disipline apo veprimtarie tjetër formuese;
- c) kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese;
- d) kurrikulat e ofruara studentëve;
- e) formën/format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët;

f) detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin;

g) kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve etj.

4. Raportet ndërmjet krediteve dhe veprimtarive të ndryshme formuese, para se të përfshihen në rregulloren mësimore të një programi studimi, miratohen në këshillat e njëjësive kryesore dhe në senatin akademik.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë garantojnë me dispozitë të veçantë të statutit të tyre rishikimin periodik të rregulloreve mësimore të programeve të studimit, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

6. Në rregulloren mësimore të një programi studimi duhet të parashikohet numri maksimal i krediteve që mund të njihen në atë program për njohuri të fituara më parë nga studentët, referuar pikës 7 të kreut II të këtij udhëzimi.

X. Grupet mësimore

1. Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, rekomandohet të organizohen me numër studentësh si më poshtë:

- a) Për programet e studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë:

Fushat e studimit	Numri i rekomanduar i studentëve cikli I	Numri i rekomanduar i studentëve cikli II
Shkenca natyrore	60	60
Shkenca të aplikuara (inxhinieri, teknologji dhe shkenca bujqësore)	100	80
Shkenca ekonomike, filologjike, historike, filozofike	120	100
Shkenca juridike, sociale, psikologjike, politike	150	120

b) Për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë:

Fushat e studimit	Numri i rekomanduar i studentëve
Stomatologji, veterinari	60
Mjekësi	80
Farmaci	100

2. Për zhvillimin e veprimtarive praktike të procesit mësimor, grupet mësimore mund të ndahen si më poshtë:

- a) grup mësimor për praktika mësimore apo profesionale 25 – 40 studentë;
- b) grup mësimor për laboratorë apo mësim praktik në AEFS 10 - 15 studentë;
- c) grup mësimor për praktika mësimore (Akad. e arteve) 5 - 10 studentë.

3. Normativat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu nuk respektohen në rastet kur numri i studentëve të regjistruar në një program studimi, është më i vogël se ai i përcaktuar në normativat e mësipërme ose në raste të tjera me vendim të Këshillit të Administrimit.

XI. Veprimtaritë e orientimit dhe të kujdestarisë (tutoratit)

1. Strukturat mësimore zhvillojnë si veprimtari institucionale:

- a) kujdestari (tutorat) për studentët;
- b) këshillim për nxënësit për përzgjedhjen e programeve të studimit;
- c) përpunim dhe shpërndarje të informacionit mbi programet e studimit, mbi funksionimin e shërbimeve për studentët;
- d) orientim për përfshirjen në tregun e punës etj.

2. Çdo institucion publik i arsimit të lartë parashikon me rregullore të posaçme kujdestarinë (tutoratin) për studentët, për çdo program studimi, nën përgjegjësinë e këshillave të fakulteteve. Ky shërbim synon mbështetjen e studentëve për parandalimin e largimeve apo zgjatjes së kohës së studimeve përtej kohëzgjatjes normale të tyre, i orienton dhe asiston studentët gjatë gjithë programit të tyre të studimit dhe i nxit për një pjesëmarrje aktive të tyre në jetën universitare në të gjitha fushat dhe format e saj.

3. Çdo institucion publik i arsimit të lartë ndërmerr nisma për t'u bërë të njohur nxënësve të viteve të fundit të shkollës së mesme, programet e studimit që ofron, strukturat përbërëse të tij dhe shërbimet për studentët, për të ndihmuar në këtë mënyrë nxënësit në zgjedhjen e ndërgjegjshme dhe të motivuar të programit/programeve të studimit.

Fakultetet e veçanta organizojnë, gjithashtu, takime orientuese, të programuara dhe të publikuara, për dhënien e informacioneve të detajuara mbi objektivat formues të programeve të ndryshme të studimit, të aktivizuara në fakultetin e tyre, organizimin e tyre, mundësitë për punësim etj.

4. Personeli akademik, brenda kompetencës së tij, është i detyruar të impenjohet në detyrat e organizuara dhe të nxitura nga shërbimet e përcaktuara më sipër.

5. Veprimtaritë e kujdestarisë zhvillohen në bashkëpunim me këshillat studentorë respektivë.

XII. Organizimi i studimeve në institucionet private të arsimit të lartë

1. Institucionet private të arsimit të lartë apo subjektet juridike private, që do të ofrojnë një model të ndryshëm programi studimi nga ai i përcaktuar në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, si parashikohet në nenin 45, pika 1 "b" të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, duhet të pasqyrojë dhe vlerësimin në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), për të mundësuar njohjen e studimeve dhe transferimet e studentëve.

Programi i studimi i paraqitur duhet të shoqërohet me rregulloren mësimore të institucionit dhe rregulloret mësimore të programit të studimit, të cilat duhet të përmbajnë elementet kryesore të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Institucionet private të arsimit të lartë, për organizimin e programeve të studimit, i referohen këtij udhëzimi, si dhe akteve të tjera për institucionet publike të arsimit të lartë, në të gjitha rastet kur nuk ka akte të tjera nënligjore që rregullojnë në mënyrë specifike organizimin e studimeve, si dhe çështje të tjera për programin e studimit, në këto institucione.

3. Një institucion privat i arsimit të lartë, që ka organizim të programeve të studimit të ndryshëm nga ai i pikës 1 të këtij kreu, është i detyruar ta njoftojë këtë publikisht, para se të fillojë regjistrimin e studentëve.

XIII. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi të gjitha institucionet e arsimit të lartë, si dhe subjektet juridike private, të cilat do të aplikojnë për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë për të ofruar programe të studimeve të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë organizojnë programet e tyre të studimit, sipas këtij udhëzimi, duke filluar nga viti akademik 2008-2009.

3. Udhëzimet e mëparshme për organizimin e studimeve, si dhe aktet e tjera nënligjore të mëparshme të cilat bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

Lista e programeve të integruara të studimit të nivelit të dytë

Programe të integruara të studimit të nivelit të dytë janë programet e mëposhtme të studimit:

- a) mjekësi e përgjithshme,
- b) stomatologji,
- c) farmaci,
- d) veterinari.

Shënim. Kësaj liste mund t'i shtohen me propozim të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës edhe programe të tjera studimesh të integruara të ciklit të dytë.

Shtojca 1

1. Programet e studimeve universitare:

- a) Programet e studimeve të ciklit të parë
3 vite akademike = 180 kredite
(60 kredite/vit x 3 vite = 180 kredite);

- b) Programet e studimeve të ciklit të dytë
2 vite akademike = 120 kredite
(60 kredite/vit x 2 vite = 120 kredite);

- c) Programet e integruara të studimit të ciklit të dytë
së paku 5 vite akademike = së paku 300 kredite
(60 kredite/vit x 5 vite = 300 kredite).

2. Krediti dhe orët mësimore respektive

a) 1 kredit në formimet universitare është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij;

- b) Sasia e përgjithshme e orëve mësimore të punës së studentit në 1 vit akademik.
 $60 \text{ kredite} \times 25 \text{ orë mësimore/kredit} = 1500 \text{ orë mësimore/vit};$

c) Orë mësimore në auditor:
 në javë = 20 - 25 orë mësimore
 në një vit akademik = 30 javë x (20-25) orë/javë = 600 ÷ 750 orë/vit (rasti kur viti akademik ka 30 javë mësim)

d) Orë mësimore për studim e përgatitje individuale të studentit:

1500 orë/vit - (600 ÷ 750) orë/vit (në auditor) = 900 ÷ 750 orë /vit (studim i ndividual).

3. Kreditet për veprimtaritë e ndryshme formuese

Kreditet për veprimtaritë e ndryshme formuese, të domosdoshme për marrjen e një titulli studimi, përcaktuar në pikën 4, shkronjat “a” dhe “b” dhe në pikën 5, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, të kreut VII të këtij udhëzimi, mund të jenë si më poshtë:

Tipi i veprimtarisë	Cikli i parë	Cikli i dytë
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	rreth 20% (rreth 36 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Disiplina të formimit karakterizues të programit	rreth 50% (rreth 90 kredite)	rreth 40% (rreth 50 kredite)
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	rreth 10% (rreth 18 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët ndërmjet atyre që ofron institucioni	7 - 8% (12 - 14 kredite)	rreth 7 - 8% (8 - 10 kredite)
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktika apo stazhe	rreth 10% (rreth 18 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Përgatitje e tezës së diplomës	3 - 4% (5 - 7 kredite)	10% - 25% (12 - 30 kredite)
Totali	180 kredite	120 kredite

3.1. Modele të mundshme për qëllime metodologjike të shpërndarjes së krediteve:

a) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të ciklit të parë në shkencat juridike

Veprimtaria formuese	Fusha disiplinore	Kredite
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	E drejta romake. Histori e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Hyrje në filozofi. Filozofia e së drejtës. Historia e institucioneve. E drejta kushtetuese. Sociologjia e së drejtës etj.	35
Disiplina të formimit karakterizues të programit	E drejta administrative. E drejta tregtare. E drejta e punës. E drejta civile. E drejta private. E drejta penale. Institucionet e së drejtës publike. Institucionet e së drejtës private. E drejta ndërkombëtare. Ekonomia politike etj.	95
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Disiplina juridike (Kriminalistikë, Mjekësi ligjore,...). Statistikë. Ekonomi tregu etj.	20
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	10
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, aftësime komunikimi e logjike, praktikë apo stazh etj.	14
Teza e diplomës		6
Totali		180

b) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të inxhinierisë mekanike

Veprimtaria formuese	Disiplina/at	Diplomë e nivelit të parë	Diplomë e nivelit të dytë
		Numri i krediteve	Numri i krediteve
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Disiplina matematike, informatikë, statistikë, fizikë e përgjithshme, kimi, fizikë eksperimentale, fizikë e trupit të ngurtë etj.	40	12
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Disiplina të inxhinierisë mekanike, energjetike, të menaxhimit etj.	90	60
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Disiplina inxhinierike, si elektroteknikë, hidraulikë, kulturë juridike ekonomike etj.	20	10
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	12	8
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, praktikë apo stazh etj.	12	10
Teza e diplomës		6	20
Totali		180	120

c) Kredite në një model të mundshëm programi të integruar studimi të ciklit të dytë: stomatologji

Veprimtaria formuese	Fusha disiplinore	Kredite
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Disiplina të përgjithshme për formimin e stomatologut (biologjia e aplikuar, fizikë, psikologji e përgjithshme, statistikë), morfologji njerëzore e funksione biologjike lidhur me organet e aparatet njerëzore (fiziologji, anatomi humane, istologji) etj.	50
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Diagnostikë laborator (biokimi klinike, biologji molekulare, patologji, mikrobiologji), disiplina mjekësore me vlerë për stomatologjinë (farmakologji, mjekësi e brendshme, anatomi patologjike, neurologji, ...), disiplina stomatologjike e radiologjike	160
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Formime ndërdisiplinore (kimi e përgjithshme, kimi organike, shkenca dhe teknologjia e materialeve), mjekësi plastike, sëmundje infektive, mjekësi ligjore, njohuri sociologjike etj.	30
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	15
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, praktikë apo stazh etj.	15
Teza e diplomës		30
Totali		300

d) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të ciklit të parë për formimin e mësuesve të ciklit të ulët

Veprimtaria formuese	Fusha disiplinore	Kredite
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Pedagogjia e përgjithshme, histori e pedagogjisë, teori dhe filozofi edukimi, psikologji e përgjithshme, psikologji zhvillimi dhe edukimi, sociologji etj.	35
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Disiplina pedagogjike e metodologjiko-didaktike, disiplina historike, gjeografike, ekonomiko-juridike, disiplina shkencore (botanikë, zoologji, kimi, fizikë, matematikë, etj), disiplina gjuhësore-letrare, disiplina artistike (muzikë, vizatim, arte figurative), disiplina sportive etj.	70
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Shkenca teknike mjekësore, higjienë e përgjithshme, higjienë mentale, didaktika dhe pedagogjia speciale etj.	15
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	10
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktikë laboratorike.	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, aftësi komunikimi e logjike, laboratorë didaktikë, që konsistojnë në analizën, hartimin dhe simulimin e veprimtarive të ndryshme didaktike	20
Praktikë pranë institucioneve shkollore		25
Teza e diplomës		5
Totali		180

4. Raporte të mundshme të veprimtarive formuese brenda 1 disipline

Shpërndarja e krediteve brenda 1 disipline mund të jetë si më poshtë:

Veprimtari formuese brenda disiplinës	Në % të numrit të krediteve për disiplinën
Leksione	50 - 85% e krediteve
Ushtrime/seminare	15 - 33% e krediteve
Laboratorë	15 - 33% e krediteve
Projekte/detyra	8 - 15% e krediteve
Totali	100% e krediteve

Modele të mundshme të ndarjes së krediteve për veprimtaritë formuese, brenda një disipline me 6 kredite, për qëllime metodologjike:

Model a

Veprimtari formuese brenda disiplinës	Numri i krediteve për çdo veprimtari brenda disiplinës
Leksione	2.5 – 5 kredite
Ushtrime	1 – 2 kredite

Zgjidhet nga lektori ndarja e krediteve në veprimtaritë e ndryshme mësimore, si më poshtë:

leksione	-	3 kredite
ushtrime	-	1.5 kredite
laboratore	-	0,5 kredite
projekt	-	1 kredit

Gjithsej 6 kredite

Zgjidhet ndarja e orëve mësimore për një kredit, në orë që zhvillohen në auditor dhe orë pune të studentit për studim individual, si më poshtë:

1 kredit leksion:	10 orë në auditor, 15 orë studim individual;
1 kredit ushtrime:	12 orë në auditor, 13 orë studim individual;
1 kredit seminare:	8 orë në auditor, 17 orë studim individual;
1 kredit laboratore:	24 orë në auditor, 1 orë studim individual;
1 kredit projekt:	2 orë në auditor, 23 orë punë individuale.

Në trajtë përmbledhëse, shpërndarja e 150 orëve mësimore punë gjithsej, në auditor dhe për studim individual, për disiplinën me 6 kredite, është si më poshtë:

Leksione:	3 kredite x 10 orë = 30 orë në auditor (45 orë studim individual)
Ushtrime:	1.5 kredite x 12 orë = 18 orë në auditor (19.5 orë studim individual)
Laboratore:	0,5 kredite x 24 orë = 12 orë në auditor (0.5 orë studim individual)
Projekt:	1 kredit x 2 orë = 2 orë në auditor (23 orë punë individuale)

6 kredite (gjithsej 150 orë) = 62 orë në auditor dhe 88 orë studim individual

Shtojca 2

Nota mesatare e ponderuar (M_p) njehsohet si më poshtë:

$$M_p = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}}$$

ku:

nd: numri i disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, përfshirë dhe tezën e diplomës;

k_{id}: numri i krediteve për një disiplinë, apo veprimtari tjetër formuese, përfshirë dhe tezën e diplomës;

N_{id}: nota e marrë në disiplinën respektive, veprimtarinë formuese apo për tezën e diplomës.

Shuma e $\sum_{i=1}^{nd} k_{id}$ do të jetë:

- 180 për programet e studimit të ciklit të parë;
- 120 për programet e studimit të ciklit të dytë;
- jo më pak se 300 për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë.

Shembull i thjeshtuar i njehsimit të notës mesatare të ponderuar të dy studentëve për tri disiplina:

Studenti I:

Disiplina D₁: Nota e marrë: N₁ = 10, kreditet: k₁ = 6 kredite;

Disiplina D₂: Nota e marrë: N₂ = 6, kreditet: k₂ = 4 kredite;

Disiplina D₃: Nota e marrë: N₃ = 7, kreditet: k₃ = 3 kredite;

$$M_p = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}} = \frac{6 * 10 + 4 * 6 + 3 * 7}{6 + 4 + 3} = 8.076$$

Studenti II:

Disiplina D₁: Nota e marrë: N₁ = 10, Kreditet: k₁ = 3 kredite;

Disiplina D₂: Nota e marrë: N₂ = 6, Kreditet: k₁ = 6 kredite;

Disiplina D₃: Nota e marrë: N₃ = 7, Kreditet: k₁ = 4 kredite;

$$Mp = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}} = \frac{3*10 + 6*6 + 4*7}{3 + 6 + 4} = 7.230$$

Për nota të njëjta, pra dhe notë mesatare aritmetike të njëjtë, nota mesatare e ponderuar është e ndryshme për dy studentët, pasi notat e njëjta i kanë marrë në disiplina me numër të ndryshëm kreditesh apo me pesha të ndryshme.

UDHËZIM

Nr.14, datë 2.4.2008

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9856, datë 16.12.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 7.5, ndryshohet si më poshtë:

“7.5 Organizatat jofitimprurëse

Për qëllimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, organizatë jofitimprurëse është çdo shoqëri, institucion, shoqatë apo organizatë, që themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe që nuk është krijuar për përfitime ose të ardhura të anëtarëve të saj dhe rregullat e së cilës nuk lejojnë shpërndarje fitimesh apo pronash për anëtarët e saj.

Në bazë të nenit 24 të ligjit, furnizimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar, që do të thotë se këto organizata duhet t'i kryejnë vetë këto furnizime dhe këto furnizime të jenë bërë kundrejt pagesës së reduktuar sipas kushteve që përcakton neni 18 i ligjit, janë furnizime të përjashtuara nëse janë furnizim shërbimesh nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqenien shpirtërore.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar kemi në ato raste kur këto organizata nuk arkëtojnë pagesë ose pagesa që ato arkëtojnë është dukshëm më e vogël se ç'duhet të ishte nëse qëllimi i tyre do të ishte fitimi, sipas nenit 18 paragrafi 4 të ligjit mbi TVSH-në. Përkundrazi, kur këto organizata i bëjnë furnizimet e mësipërme kundrejt pagesës së plotë, ato bëjnë furnizime të tatueshme. Nëse një organizatë jofitimprurëse kryen veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, ajo kryen veprimtari të tatueshme, pavarësisht nëse pagesa është e reduktuar apo e plotë. Në këtë rast, në qoftë se volumi i qarkullimit është më i madh se 8 milionë lekë, ajo është e detyruar të regjistrohet dhe të paguajë TVSH.”.

Në bazë të paragrafit të dytë të nenit 4 të dekretit të Presidentit, nr.1510, datë 28.6.1996 “Për disa ndryshime në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar”, mallrat e importuara kundrejt pagesës së reduktuar si ndihmë humanitare nga organizatat bamirëse humanitare, institucionet e kultit, entet publike, si dhe institucionet shtetërore buxhetore me qëllim kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit, nuk ngarkohen me TVSH.

2. Pika 7.8, ndryshohet si më poshtë:

“7.8 Barnat dhe pajisjet mjekësore

Furnizimi i barnave dhe i ambalazheve e materialeve që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara.”.

3. Pika 7.9, paragrafit të parë “Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat brenda vendit është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar”, i shtohet fjalia “Kjo pikë nuk zbatohet për furnizimin në import të periodikëve, revistave, shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji”.

4. Pika 7.9.3, gjatë gjithë përmbajtjes së saj, ndryshohen shprehjet si më poshtë:

“- shprehja “për një periudhë deri në gjashtë muaj” ndryshohet në “për një periudhë deri në dymbëdhjetë muaj”;

- shprehja “shtyhet deri në deri në gjashtë muaj” ndryshohet në “shtyhet deri në dymbëdhjetë muaj”;

- shprehja “mbarimi i periudhës gjashtëmuajore” ndryshohet në “mbarimi i periudhës dymbëdhjetëmuajore”;

- shprehja “brenda gjashtë muajve”, ndryshohet në “brenda dymbëdhjetë muajve”;

- shprehja “por jo më vonë se gjashtë muaj nga momenti i importimit” ndryshohet në “por jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga momenti i importimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

VENDIM

Nr.11, datë 2.4.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 15.10.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42/1 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga z.Enkelejd Alibeaj, me autorizim.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga z.Selim Kryeziu, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 315 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 42 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës pretendon se neni 315 i Kodit Penal është i papajtueshëm me nenet 7, 42/2 dhe 145/1,3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për këto arsye:

- neni 315 i Kodit Penal bie ndesh me nenin 145/1, 3 të Kushtetutës, që garanton pavarësinë e gjyqtarëve, të cilët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (neni 145/1) dhe që parashikon se çdo ndërhyrje në pavarësinë e gjykatave passjell përgjegjësi ligjore (neni 145/3);

- bazuar në nenin 315 të Kodit Penal, pasi një gjyqtar të jetë shprehur me një vendim përfundimtar, çdokush, në çdo kohë, mund të pretendojë se vendimi është i padrejtë dhe të bëjë kallëzim penal kundër tij/saj. Gjyqtarët do të viheshin nën presionin e kallëzimit penal dhe ndjekjes penale. Kjo situatë mund të cenojë rëndë pavarësinë, paanësinë dhe bindjen e brendshme të gjyqtarit;

- neni 315 i Kodit Penal bie në kundërshtim me të drejtën për një proces të rregullt ligjor (neni 42/2 i Kushtetutës), elemente të të cilit janë “gjykimi i drejtë”, “gjykata e pavarur” dhe “gjykata e paanshme”. Secili prej këtyre elementeve mund të cenohet, meqenëse gjyqtari, për shkak të vendimit përfundimtar të dhënë prej tij, mund të vihet në çdo moment nën presionin e kallëzimit dhe hetimit penal;

- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Deklarata Universale mbi Pavarësinë e Organeve Gjyqësore, Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Pushtetit Gjyqësor të OKB-së, i garantojnë gjyqtarit imunitet nga ndjekja penale.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar pajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dispozitës ligjore të sipërcituar:

- neni 315 i Kodit Penal është në përputhje me parimet themelore kushtetuese mbi të cilat funksionon legjislatiioni penal dhe ka elementet e mjaftueshme për t’u konsideruar si vepër penale;

- rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre penale është e lartë, pasi cenon parashikime të tilla kushtetuese, si: barazia para ligjit, pavarësia e sistemit të drejtësisë dhe dhënies së saj, të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve, vendimmarrja e mbështetur vetëm në bindjen e brendshme në bazë të ligjit dhe provave;

- parimet e sanksionuara në nenet 7, 42/2 dhe 145/1/3 të Kushtetutës janë komplementare me parimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies së gjyqtarëve;

- pavarësia dhe paanësia e gjyqtarit nuk ruhen duke eliminuar sistemin e kontrollit, por duke forcuar mekanizmat garantues të ngarkuar të japin vlerësim objektiv;

- gjyqtarët nuk janë kategori që nuk mund të merren në përgjegjësi penale për veprime që kryhen gjatë ushtrimit të detyrës. Mundësia e ndjekjes penale të gjyqtarit parashikohet nga neni 137 i Kushtetutës për anëtarët e Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit dhe gjykatave të rrethit, ndërsa procedura e ndjekjes penale të gjyqtarit kushtetues parashikohet nga neni 126 i Kushtetutës;

- gjyqtarët e zakonshëm nuk kanë imunitet nga përgjegjësia penale për akte të dhëna në ushtrim të detyrës së tyre. Kushtetuta nuk e parashikon këtë dhe është legjislatiioni dhe zgjedhja e legjislatorit që përcakton se cila do të jetë përmasa e kësaj përgjegjësie;

- neni 315 nuk cenon nenin 42, pika 2, pasi gjyqtarit i krijohet mundësia të gjykohej sipas të gjitha garancive kushtetuese dhe procedurale. Ndjekja penale ndaj një gjyqtari nuk mund të fillojë pa miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo Gjykatës Kushtetuese, sipas rastit. Këto organe kanë pavarësi të mjaftueshme për të vlerësuar paraprakisht faktet, provat ose të dhënat mbi besueshmërinë e tyre;

- neni 315 i Kodit Penal duhet të interpretohet kur gjyqtari vendos me bindjen e brendshme në kundërshtim të hapur me ligjin.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, z.Sokol Berberi, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që u shpreh se ia lë në çmim Gjykatës Kushtetuese, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Shtetasi P.B., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për *“kundërshtimin e vendimit të pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës”* lidhur me kallëzimin që ai ka bërë ndaj tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë për kryerjen e veprës penale të *“Dhënies së vendimit të padrejtë”*, parashikuar nga neni 315 i Kodit Penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datë 18.3.2003, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të tre gjyqtarëve, me arsyetimin se vendimi i Gjykatës është i formës së prerë dhe se nuk ekziston vepra penale.

Me vendimin nr.80, datë 19.3.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes së sjellë nga shtetasi P.B., dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 315 të Kodit Penal. Ajo ka çmuar se: ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet nenit 315 të Kodit Penal dhe zgjidhjes së çështjes penale të paraqitur për gjykim; neni 315 i Kodit Penal është i papajtueshëm me nenet 7, 42/2 dhe 145/1, 3 të Kushtetutës.

Këto dispozita të Kushtetutës deklarojnë:

Neni 7: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.*

Neni 42/2: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

Neni 145/1: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.*

Neni 145/3: *“Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit”.*

II

1. Gjykata, përpara se të vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 315 të Kodit Penal, e çmon të nevojshme të shprehet paraprakisht për kuptimin e standardeve kushtetuese për pavarësinë dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave.

Analiza e mëposhtme do të ndalet në paraqitjen e normave kushtetuese dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), si dhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) lidhur me këto standarde.

2. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve. Ky parim do të thotë që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori, janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe duhet të ketë një balancë midis tyre. Çdo institucion i një pushteti gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, nga raportet e fuqive të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*).

Pushteti gjyqësor, sipas nenit 135 të Kushtetutës, ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e rrethit. Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve.

3. Në nenin 145/1 parashikohet se: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.* Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është që, ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave.

4. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*).

Pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj, që janë: paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit dhe e gjykatës. Paanshmëria i referohet një qëndrimi subjektiv të gjyqtarit në lidhje me çështjen dhe me palët pjesëmarrëse në të, ndërsa pavarësia, e cila duhet të bazohet në ekzistencën e disa kushteve dhe të garancive objektive, nënkupton jo vetëm një qëndrim të caktuar ndaj ushtrimit të funksionit gjyqësor, por dhe një pozitë ose marrëdhënie në raport me të tjerët, veçanërisht me pushtetin ekzekutiv (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 22.5.2006*).

Kushtetuta e ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe gjyqtarëve. Në paragrafin e tretë të nenit 145 të saj parashikohet: “Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit”. Pavarësia procedurale e gjyqtarit është një kusht i nevojshëm për një shqyrtim të pavarur dhe të paanshëm të çështjes. Kjo normë e Kushtetutës ngarkon institucionet dhe pushtetet e tjera me detyrën kushtetuese që të respektojnë pavarësinë e gjykatave.

Është për t’u theksuar se pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave në dhënien e drejtësisë, e garantuar nga Kushtetuta, duhet të mbrohet dhe të mos cenohet nga ligjet dhe aktet e tjera ligjore. Në një shtet demokratik, bazuar në shtetin e së drejtës, ligjvënësi ka të drejtën dhe detyrën të përcaktojë me ligj veprat penale nga të cilat shkaktohet një dëm thelbësor në interesat e personave, të shoqërisë ose të shtetit, ose krijojnë rrezikun se një dëm i tillë do të mund të ndodhë. Për rregullimin e marrëdhënieve të lidhura me përgjegjësinë penale, ligjvënësi gëzon një diskrecion të gjerë. Sidoqoftë, ky diskrecion i ligjvënësit është i kufizuar nga parimet dhe normat e Kushtetutës.

Gjykata është shprehur se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka detyrën për të “qeverisur” gjyqësorin dhe, sipas neni 147 të Kushtetutës, është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen me korpusin gjyqësor. Frymën e vetëqeverisjes në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kushtetutbërësi e ka përfshirë me qëllimin për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e çdo pushteti tjetër (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 22.5.2006*).

5. Statusi ligjor i gjyqtarëve dhe i gjykatave duhet gjithashtu t’i shërbejë garancisë së pavarësisë së tyre. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.5.2004*).

Bazuar në nenin 137 të Kushtetutës, gjyqtarët mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD-së). Nëse Këshilli i Lartë i Drejtësisë jep autorizimin për ndjekje penale, atëherë gjyqtarit duhet t’i garantohen të gjitha garancitë procedurale penale, përfshi parimin e prezumimit të pafajësisë, dhe në fund është gjykata që vendos çështjen e përgjegjësisë penale të gjyqtarit.

Gjykata çmon se sistemi i garancive të pavarësisë së gjyqtarëve dhe të gjykatave nuk krijon ndonjë parakusht mbi bazën e të cilit gjyqtari mund t'i shmangët përmbushjes së detyrave të tij në mënyrë të plotë, të shqyrtojë çështjet në një mënyrë të papërshtatshme, të veprojë në mënyrë joetike me personat që marrin pjesë në çështje, të shkelë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin etj... Gjyqtarët duhet të mbrojnë nderin dhe prestigjin e detyrës së tyre. Për rrjedhojë, sistemi i vetëqeverisjes së gjyqësorit duhet të sigurojë që gjyqtarët t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë korrekte, me qëllim që çdo veprim joligjor ose joetik të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme.

6. Pavarësia nuk është qëllim në vetvete ose një mënyrë për të siguruar pozicionin profesional të gjyqtarëve për të mirën e tyre, por është një mjet për të arritur qëllimet e një shoqërie të drejtë dhe të përparuar. Për këtë arsye, pavarësia shoqërohet me mjete për të siguruar që gjyqtarët dhe gjyqësori në tërësi të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike.

Gjyqtari betohet se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndrojë kurdoherë besnik Kushtetutës, ligjeve dhe do të respektojë rregullat e etikës profesionale. Ai duhet të ruajë dinjitetin e tij, duke mos lejuar veprime që komprometojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tij në shoqëri. Gjyqtari duhet ta shmangë një konflikt të mundshëm interesi që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanshmërinë e tij në dhënien e drejtësisë. Për këtë qëllim, Kushtetuta, në nenin 143 përcakton : "Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private".

Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep gjyqtarëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim.

Për shkelje të funksioneve të tyre gjyqtarët mund të mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe penale. Bazuar në nenin 147 të Kushtetutës, gjyqtarët shkarkohen nga detyra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Sjellja e një gjyqtari lidhur me veprimtarinë e tij, për detyrat e tij funksionale, si dhe për veprimtarinë e tij jashtë detyrës, nuk duhet të krijojë dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

Gjykata çmon se në vendimmarrje gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa ndikim të papërshtatshëm, presione, kërcënime ose ndërhyrje, të drejtpërdrejta ose jo, nga kushdo dhe për çfarëdo arsye. Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës.

Gjykata është shprehur se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.5.2004*).

7. Është e nevojshme të theksohet, se parimi i pavarësisë së gjyqtarëve është gjithashtu i sanksionuar në një sërë dokumentesh ndërkombëtare: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit miratuar nga Asambleja e OKB-së; Rekomandimi për Pavarësinë, Efiçencën dhe rolin e gjyqtarëve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës; Karta Universale e Gjyqtarit etj... Këto dokumente ndërkombëtare në tërësi identifikojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit, si: gjyqtari duhet të ketë autoritetin për të vendosur për çështjet i lirë nga çdo ndërhyrje; ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të përfshihen në rendin kushtetues; gjykatat dhe gjyqtarët duhet të kenë pavarësi administrative dhe të përfshihen në procesin buxhetor; mbrojtja e gjyqtarëve nga shfuqizimi arbitrar ose rishikimi i vendimeve të tyre duhet të jetë i garantuar; pavarësia ndër-institucionale që është e drejta e gjyqtarëve për të marrë vendime pa ndërhyrje të papërshtatshme nga gjykatat më të larta; etj..

8. Konceptet e pavarësisë dhe të paanësisë së gjyqësorit janë trajtuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në kuadrin e nenit 6 të KEDNJ, i cili përcakton standarde për procesin gjyqësor. Neni 6/1 i KEDNJ parashikon se “çdo person ka të drejtë të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj...”.

GJEDNJ është shprehur se vendimet e gjykatave duhet të jenë përfundimtare dhe të detyrueshme, me përjashtim të rasteve kur ato shfuqizohen nga një gjykatë më e lartë, në bazë të parregullsisë ose të qenurit të padrejta (*Shih vendimin: Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 10.6.1996). GJEDNJ mbështet qëndrimin se një gjyqtar prezumohet i lirë nga çdo anshmëri dhe e kalon barrën e provës në këtë rast të kundërshtuesi i prezumimit dhe se çdo gjyqtar është i paanshëm, deri sa të provohet e kundërta. Lidhur me paanësinë objektive, GJEDNJ është shprehur në shumë raste se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimin “Hauschildt kundër Danimarkës”, datë 24.5.1989; vendimin: Fey kundër Austrisë”, datë 24.2.1993, Vendimin “Gautrin et al kundër Francës”, datë 20.5.1998*).

III

9. Gjykata, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e nenit 315 të Kodit Penal e çmon të nevojshme të analizojë elementet e kësaj vepre penale, duke u mbështetur pikësepari në doktrinën e së drejtës penale. Neni 315 i Kodit Penal parashikon: “Dhënia e një vendimi gjyqësor përfundimtar që dihet se është i padrejtë dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”. Kodi Penal është miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995.

10. Vepra penale e “Dhënies së një vendimi të padrejtë” përfshihet në kreun IX të Kodit Penal, i cili synon mbrojtjen e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, në radhë të parë, nga vetë përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë. Vepra penale kundër drejtësisë janë ato veprime ose mosveprime të kundërligjshme të kryera me faj, që prekin veprimtarinë e rregullt të gjykatës për realizimin e drejtësisë, të organeve që ndihmojnë në realizimin e saj, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve të mbrojtura me ligj. Ligjvënësi, me parashikimin e kësaj vepre penale, është nisur nga një qëllim i ligjshëm: mbrojtja e shtetit të së drejtës, e lirive dhe e të drejtave të qytetarëve.

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, që sigurojnë realizimin e drejtësisë nga gjykata, si edhe të drejtat dhe liritë e shtetasve, të shoqërive tregtare, institucioneve, organizatave e shoqatave, të mbrojtura me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, kjo vepër penale shfaqet me dhënien e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga gjykata, që dihet se është i padrejtë. Kuptimi i vendimit përfundimtar është dhënë në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile. Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit, i cili e zgjidh çështjen në themel (neni 126 i Kodit të Procedurës Civile). Vendimi përfundimtar i gjykatës është sinteza e gjykimit dhe përfaqëson zgjidhjen e çështjes në themel mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Element i anës objektive është edhe që vendimi përfundimtar të jetë i padrejtë.

Gjyqësori, në kryerjen e funksioneve, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (neni 142). Kodi i Procedurës Penale lidhur me vendimin penal parashikon se vendimi arsyetohet, ndryshe është i pavlefshëm. Neni 383 i Kodit të Procedurës Penale parashikon elementet që duhet të përmbajë një vendim, ku ndër të tjera parashikon një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit. Kodi i Procedurës Civile parashikon se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi duhet qartësuar që pavarësia dhe diskrecioni i gjykatës kanë një kufizim, nënshtrimin ndaj Kushtetutës dhe ligjeve. Ky kufizim qëndron edhe në parashikimin e një sërë kontrollesh të brendshme ndaj një procesi. Vendimi, siç u përmend më sipër, mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse. Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve.

Nisur nga një interpretim *a contrario* me atë të shtjelluar më sipër, që një vendim të jetë i padrejtë në kuptim të nenit 315 të Kodit Penal, ai duhet të jetë marrë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet dhe/ose të jetë i pa arsyetuar. Njëkohësisht ky vendim duhet të jetë në kundërshtim me kërkesat specifike të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale.

Subjekt i veprës penale është gjyqtari që jep vendimin gjyqësor përfundimtar.

Gjykata, lidhur me anën subjektive të veprës, çmon se formulimi i dispozitës krijon mundësi për dykuptimësi në interpretimin e saj. Sipas një interpretimi, fraza “dihet që është i padrejtë” nënkupton rastin kur gjyqtari me ndërgjegje dhe paramendim jep një vendim përfundimtar që e di se është i pabazuar dhe i paligjshëm. Sipas një tjetër interpretimi, pavarësisht nga ana subjektive e gjyqtarit, vendimi gjyqësor që “dihet që është i padrejtë”, do të konstatohej mbi bazën e një kriteri objektiv, siç mund të jetë prishja e vendimit nga një gjykatë më e lartë, ndryshimi i një praktike gjyqësore të konsoliduar etj...

11. Bazuar në standardet e trajtuara më sipër, Gjykata vlerëson se testi objektiv i paanshmërisë konsiston në përcaktimin se edhe pa marrë parasysh sjelljen e gjyqtarit, ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshime për sa i takon paanshmërisë së tij. Në këtë rast, organi i akuzës dhe gjykata, kur shqyrtojnë nëse në një çështje të caktuar, ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, vendimtar mbetet përcaktimi se dyshimi mbi paanshmërinë është objektivisht i justifikueshëm. Ana subjektive e paanshmërisë ka të bëjë me bindjen personale të një gjyqtari për një çështje të caktuar, e cila prezumohet derisa të paraqiten prova që dëshmojnë të kundërtën.

12. Gjykata çmon se analiza e ndërgjegjes ose e dijenisë do të lidhej me një analizë të bindjes së brendshme të gjyqtarit e krijuar gjatë procesit vendimmarrës dhe e bërë e ditur me shpalljen e vendimit. Kjo analizë e ndërgjegjes së gjyqtarit do të përbënte një ndërhyrje në vetë thelbin e pavarësisë funksionale të gjyqtarit. Paqartësia në përcaktimin e anës subjektive të veprës krijon mundësi që organi i akuzës të fillojë një çështje penale ndaj gjyqtarit mbi bazën e kallëzimit të palëve, me pretendimin se vendimi dihet që është i padrejtë, pavarësisht se sa kjo mund të provohet objektivisht. Dispozita penale objekt shqyrtimi, nuk shmang mundësinë që gjyqtari të vihet në ndjekje penale vetëm për faktin se ai ka dhënë një vendim sipas bindjes së tij të mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Hapësira që lejon kjo vepër mund të krijojë një presion të papërshtatshëm ndaj gjyqtarit, çka do të dëmtonte dhënien e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjykata çmon së mundësia e fillimit të ndjekjes penale ndaj një gjyqtari për dhënien e një vendimi përfundimtar, ndërkohë që vendimi mund të shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë, krijon një presion të papërshtatshëm mbi këtë të fundit, çka mund të cenojë dhënien e drejtësisë.

13. Siç dhe u analizuan më sipër, standardet kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit përcaktojnë disa elemente të qenësishme, ndër të cilët pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese lidhet ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këta realizojnë. Duhet ritheksuar se parimi i prezumimit të paanshmërisë së gjyqtarit pasqyron një element të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, që do të thotë se vendimet e gjykatave duhet të jenë përfundimtare dhe të detyrueshme, me përjashtim kur shfuqizohen nga një gjykatë më e lartë në bazë të parregullsisë ose të qenurit të padrejta.

Gjykata, siç u përmend edhe më lart, është shprehur se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur sipas ligjit.

Nëse një vendim është objektivisht i pabazuar në ligj dhe fakte, ai mund të rishikohet nga një gjykatë më e lartë ose gjyqtari mund të mbajë përgjegjësi disiplinore sipas procedurave përkatëse. Gjyqtari që jep një vendim gjyqësor për interes ose për shkaqe të dobëta, nuk shmanget nga përgjegjësia penale. Në këtë rast, Kodi Penal parashikon vepra të tjera penale, të cilat mund të kryhen nga një gjyqtar, si p.sh.: “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248), “Korrupsioni” (neni 319/a).

Mbështetur në analizën e mësipërme, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se neni 315 i Kodit Penal është i papajtueshëm me nenet 42 dhe 145 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 134, pika 1, shkronja “d”; 145, pika 2, të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e nenit 315 të Kodit Penal “Dhënia e një vendimi të padrejtë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Kristofor Peçi.

MENDIM PAKICE

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për këto arsye:

Në kërkesën e bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për shpalljen si antikushtetues të nenit 315 të Kodit Penal, pretendohet se ky nen është në kundërshtim me nenet 7, 42/2 dhe 145/1, 3 të Kushtetutës.

Neni 315 i Kodit Penal bën fjalë për përgjegjësinë penale të gjyqtarëve, në rastet kur japin vendime përfundimtare të padrejta në mënyrë të qëllimshme. Për t'i dhënë përgjigje kërkesës, para Gjykatës Kushtetuese shtroheshin për zgjidhje këto çështje kryesore:

- A ka përgjegjësi penale gjyqtari për krime të kryera në detyrë ose për shkak të saj?

- Neni 315 është antikushtetues apo është i panevojshëm, meqenëse gjyqtari mund të përgjigjet penalisht njëlloj si nëpunësit e tjerë të shtetit për shpërdorim detyre, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

- Neni 315 i Kodit Penal është antikushtetues në thelbin e tij apo formulimi është i pasaktë, ose i paplotë dhe mund të krijojë probleme në zbatimin praktik?

- A kërcënohet realisht pavarësia e gjyqtarit nga ekzistenca e kësaj dispozite në Kodin Penal?

Në lidhje me çështjen e parë, ajo ç'ka mund të thuhet pa hezitim është se gjyqtarët, si të gjithë nëpunësit apo shtetasit e tjerë, janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit dhe përgjigjen njëlloj për shkelje të tyre. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e pranon përgjegjësinë penale të gjyqtarëve. Në nenin 137 të saj thuhet shprehimisht se gjyqtarët e të gjitha niveleve mund të ndiqen penalisht.

Në nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut thuhet, ndër të tjera, se: “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...”. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.14/2006, shprehet se “...pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj, që janë: paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit (me dallimet përkatëse mes tyre).

Paanshmëria i referohet një qëndrimi subjektiv të gjyqtarit në lidhje me çështjen dhe me palët pjesëmarrëse në të, ndërsa pavarësia nënkupton jo vetëm një qëndrim të caktuar ndaj ushtrimit të funksionit gjyqësor, por një pozitë ose marrëdhënie në raport me të tjerët, veçanërisht me pushtetin ekzekutiv, që bazohet në ekzistencën e kushteve dhe garancive objektive...”. Paanshmëria e gjyqtarit në dhënien e drejtësisë dhe, në raport me qëndrimin ndaj saj, përgjegjësia që gjyqtarët duhet të mbajnë, zë një vend të rëndësishëm dhe në dokumente të organizmave ndërkombëtare, të cilat trajtojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit. Të tilla mund të përmendim: “Parimet bazë të OKB-së për pavarësinë e gjyqësorit”, Rekomandimin nr.R(94)12, datë 13.10.1994 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “ Për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve”, Kartën e Shoqatës së Gjyqtarëve Europianë etj.. Këto dokumente të rëndësishme ndërkombëtare trajtojnë gjerësisht jo vetëm parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, por dhe parimin e paanësisë në kuptim të përgjegjësisë së tyre në vendimmarrje, duke shmangur presionet, mitmarrjen, ndërhyrjet etj... Megjithëse pavarësia dhe përgjegjësia e gjyqtarëve, që buron nga parimi i paanësisë, duken si kontradiktore me njëra-tjetrën, ato në fakt nuk janë gjë tjetër veçse dy anët e së njëjtës medalje. Respekti dhe besimi ndaj drejtësisë, ndaj pushtetit gjyqësor mund të cenohet rëndë si nga ndërhyrjet e pushteteve të tjera, ashtu dhe nga qëndrimet e papërgjegjshme të gjyqtarëve në vendimmarrje, me fjalë të tjera, nga deformimet e qëllimshme të sensit të drejtësisë në zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Patundshmëria e gjyqtarëve në detyrë, një veçori kjo e rëndësishme e pushtetit gjyqësor, në raport me pushtetet e tjera, e bën akoma më evidente jo vetëm nevojën për pavarësi të tyre në dhënien e drejtësisë, por edhe paanësinë e tyre jashtë çdo ndikimi dhe tundimi. Pushteti gjyqësor është krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe pushteti që gjyqtarët kanë në raport me nëpunësit e pushteteve të tjera është shumë i madh. Pasojat që vijnë nga shpërdorimi i këtij pushteti janë të rënda. Komisioni i Venecias, në opinionin e tij nr.246/2003, shprehet, ndër të tjera, se: “...Rrjedhojë më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqësorit është mospërgjegjësia e tyre për vendimet e marra. Megjithatë, pasojat/efektet e pushtetit dhe besimi që shoqëria u jep gjyqtarëve, janë të tillë që duhet të ketë disa mënyra për t’i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshi dhe largimin nga detyra në rast të shkeljeve aq të mëdha që justifikojnë këtë veprim... Duhet të dallojmë ndërmjet përgjegjësisë penale, civile dhe disiplinore. **Gjyqtarët, të cilët gjatë detyrës kryejnë atë që në çdo rrethanë do të konsiderohet si krim, nuk mund të pretendojnë imunitet nga procesi i zakonshëm penal.** Por, ata duhet të përjashtohen krejtësisht nga përgjegjësia penale për dështime të paqëllimshme në kryerjen e funksioneve të tyre...”. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në një sërë vendimesh të saj, shprehet se koncepti i pavarësisë dhe paanësisë objektive janë të lidhur ngushtësisht. Pavarësia nuk është qëllim në vetvete, ose një mënyrë për të siguruar pozicionin profesional të gjyqtarëve për të mirën e tyre, por një mjet për të arritur qëllimet e një shoqërie të drejtë dhe të përparuar. Pavarësisht se dokumentet ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqtarëve nuk trajtojnë në mënyrë të posaçme përgjegjësinë penale të gjyqtarëve, por vetëm atë disiplinore, kjo nuk mund të përbëjë shkak për të arritur në përfundimin se gjyqtarët nuk mund të përgjigjen penalisht, me “argumentin” se cenohet pavarësia e tyre. E drejta penale është një kategori e veçantë e së drejtës, për rrjedhojë dhe përgjegjësia penale, subjekte të së cilës mund të jenë pa përjashtim të gjithë shtetasit, përfshirë dhe gjyqtarët, duke respektuar natyrisht kriteret dhe normat që lidhen me imunitetin.

Dispozita e kontestuar si antikushetuese bën fjalë për **dhënien e një vendimi gjyqësor përfundimtar që dihet se është i padrejtë**. Në këtë formulim të ligjvënësit dallojmë dy elemente thelbësore që do të na ndihmojnë për t’i dhënë përgjigje çështjes së shtruar për zgjidhje. E para, që një person (gjyqtari) të ketë përgjegjësi penale në bazë të nenit 315 të Kodit Penal, duhet të ketë dhënë **një vendim gjyqësor përfundimtar dhe**, e dyta, vendimi duhet të **dihet që është i padrejtë**. Vendimi gjyqësor është përfundimtar kur janë shteruar të gjitha mjetet për kundërshtimin e tij, ose kur ai ka marrë formë të prerë, që do të thotë se ai ose nuk është apeluar apo kundërshtuar me rekurs nga subjektet e interesuara, ose kur pas shterimit të këtyre mjeteve është marrë një vendim, sipas rastit, nga gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë. Kushti i dytë, dijenia për dhënien e një vendimi të padrejtë, në kuptimin juridiko-penal, nuk lidhet me vlerësimin profesional që bëjnë gjykatat e niveleve më të larta, aq më pak prokurori, por me qëndrimin subjektiv të gjyqtarit ndaj zgjidhjes në themel të çështjes.

Pra, nuk është fjala “...për dështime të paqëllimshme në kryerjen e funksioneve të tyre”, që do të thotë se vendimi mund të jetë pasojë e paaftësisë së gjyqtarit apo e vlerësimit të gabuar të provave dhe rrethanave të tjera të çështjes. Përkundrazi, sipas kësaj dispozite, gjyqtari, në mënyrë të qëllimshme, jep një vendim gjyqësor përfundimtar që ai e di se është i padrejtë. Pikërisht ky qëndrim subjektiv e bën atë (gjyqtarin) përgjegjës penalisht, sipas nenit 315 të Kodit Penal. Në të drejtën penale, që personi të përgjigjet për një veprë penale, para së gjithash duhet të konkurrojnë tri elemente themelore: rrezikshmëria shoqërore e veprës, kundërligjshmëria e saj dhe faji. Këto elemente (bashkë me elementet e tjera që karakterizojnë figurën e një veprë penale) janë të pranishme dhe në ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 315 i Kodit Penal.

Misioni i gjyqtarëve është të japin drejtësi, në mënyrë të pavarur, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Çdo qëndrim i kundërt i tyre, pra shkelja e qëllimshme e Kushtetutës dhe ligjeve, nuk ka asgjë të përbashkët me parimin kushtetues të pavarësisë në marrjen e vendimeve.

Çështja e dytë dhe e tretë nuk kanë lidhje me antikushtetutshmërinë ose jo të nenit 315 të Kodit Penal. Vendi apo kreu në të cilin bën pjesë një veprë në Kodin Penal nuk ka të bëjë me kushtetutshmërinë e veprës, por me metodikën që ndjek ligjvënësi në hartimin e Kodit. Pavarësisht se neni 315, në thelbin e vet, ka ngjashmëri të theksuar me elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, veçoria e tij qëndron në një element të posaçëm të kësaj veprë: te subjekti i cili është gjyqtari. Ligjvënësi e ka parë të arsyeshme, me të drejtë, që këtë dispozitë ta përfshijë në një kre të posaçëm të Kodit Penal, kreu IX, të titulluar “Vepra penale kundër drejtësisë”. Nxjerrja e saj si dispozitë më vete në këtë kre, për shkak të subjektit të posaçëm, nuk ka pse ta bëjë normën antikushtetuese. Përkundrazi, ligjvënësi ka dashur t’i japë rëndësi të veçantë pasojave të abuzimit me detyrën nga ana e gjyqtarëve dhe, në këtë kuptim, neni 315 i Kodit Penal, veç të tjerash, ushtron dhe një ndikim pozitiv për të parandaluar dhënien në mënyrë të qëllimshme të vendimeve gjyqësore haptazi të padrejta. Megjithëse qartësia e normës juridike, përderisa ka të bëjë me zbatimin në praktikë të saj, është pjesë e shqyrtimit në gjykimin kushtetues, doktrina e së drejtës penale e ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të qartë kuptimin juridik të kësaj dispozite në të gjitha elementet përbërëse të një veprë penale.

Pas kësaj analize erdhëm te çështja e fundit: a kërcënohet pavarësia e gjyqtarit nga ekzistenca e kësaj dispozite në Kodin Penal? Për t’i dhënë përgjigje, çështja duhet parë si në aspektin formal, ashtu dhe atë substancial. Nga pikëpamja formale juridike, neni 315 i Kodit Penal nuk është gjë tjetër veçse konkretizim i mëtejshëm, në vendin e duhur, i një prej rasteve kur gjyqtarët mund të vihen para përgjegjësisë penale, ndër të tjera edhe për abuzime me detyrën, përgjegjësi e cila parimisht është pranuar dhe në nenin 137 të Kushtetutës. Në aspektin substancial, vetë ekzistenca e një dispozite penale nuk mund të përbëjë aspak një kërcënim për pavarësinë e gjyqtarëve, për shkak se ai është i mbrojtur në mënyrë të posaçme si nga Kushtetuta, ashtu dhe nga ligjet organike me garanci të shumta. Sipas nenit 137 të Kushtetutës, gjyqtarët mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Garancitë janë më të mëdha kur është fjala për të ndjekur penalisht gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, për të cilët kërkohet miratimi i Kuvendit dhe për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, për të cilët nevojitet vetë miratimi i kësaj të fundit.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Gjergj Sauli.

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.488, datë 15.2.2008, shpall të vdekur shtetasin Enkeleid Gjuzi, i datëlindjes 18.12.1973, me datë vdekjeje 25.3.1994.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 14.4.2008
Doli nga shtypi më 16.4.2008

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë